



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 qershor 2019  
Nr. ref.: RK 1382/19

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin nr. KI21/19**

Parashtrues

**Pjetër Boçi**

**Kërkesë për interpretimin e legjislacionit relevant në lidhje me  
definimin e “pozitës zyrtare”**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është Pjetër Boçi, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston ndonjë vendim specifik të një autoriteti publik.

## Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për interpretimin e legjislacionit relevant për të përcaktuar nëse parashtruesi i kërkesës, si instruktor i praktikës në autoshkollën "Geni", është "person zyrtar".

## Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 1 shkurt 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 8 shkurt 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 15 shkurt 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 8 maj 2019, Gjykata në përbërje të plotë njëzëri vendosi që kërkesa të shtyhet për shqyrtim në njërin nga seancat e radhës, për arsye të ndërrimit të Gjyqtarit raportues, pasi që i njëjti gjyqtar raportues ka qenë gjyqtar raportues në një rast të mëhershëm të të njëjtit parashtrues.
9. Më 14 maj 2019, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Radomir Laban, gjyqtar raportues për të paraqitur raportin para Gjykatës, dhe Kolegjin e ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
10. Më 27 maj 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## Përmbledhja e fakteve

11. Më 22 nëntor 2018, Gjykata nxori Aktvendim për papranueshmëri në rastin KI76/18, parashtrues: *Pjetër Boçi*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 279/2017, të 26 marsit 2018, dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 462/2018, të 28 majit 2018. Gjykata në këtë rast kishte trajtuar, ndër të tjera, edhe pretendimin e

parashtruesit se në procedurë penale në gjykatat e rregullta nuk janë aplikuar drejt dispozitat në lidhje me definicionin e “personin zyrtar”.

12. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tanishme (KI21/19) pohon se *“kam një kontest gjyqësor për pozitën në punën që ushtroj. Unë punoj instruktor i praktikës në autoshkollën "GENI" biznes individual me nr. biznesi 70686643 [...]”*.
13. Parashtruesi kërkon nga Gjykata *“të bëni interpretimin e ligjit të pozitës së punës, se a jam unë person zyrtar duke ditur, se nuk jam i zgjedhur, nuk jam i emëruar, nuk kam autorizimin zyrtar, nuk punoj në organizata shtetërore, nuk punoj në asnjë organizatë biznesi dhe nuk jam i licencuar si ekzaminier për testimin e kandidatëve në teori dhe praktikë”*.
14. Parashtruesi i kërkesës nuk specifikon kontestin gjyqësor në lidhje me të cilin kërkon interpretimin e cekur më lart por i bashkëngjitë kërkesës disa dokumente, ndër të tjera, certifikatën e biznesit të autoshkollës “Geni”; përgjigjen e Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me kërkesën e parashtruesit nëse ai është “person zyrtar”; vërtetimin nga Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë në lidhje me pronarin e autoshkollës “Geni”; dhe përgjigjen e Ministrisë së Infrastrukturës në lidhje me kërkesën e parashtruesit nëse ai është i licencuar për të kryer vlerësimin e kandidatëve për shofer.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

15. Parashtruesi i kërkesës nuk ka kontestuar asnjë akt konkret të ndonjë autoriteti publik dhe nuk ka saktësuar se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë, pretendon se i janë cenuar përmes ndonjë akti të një autoriteti publik.
16. Parashtruesi i kërkesës nuk ka ndonjë pretendim konkret por kërkon që Gjykata të bëjë *“interpretimin e ligjit [...], se a jam unë person zyrtar duke ditur, se nuk jam i zgjedhur, nuk jam i emëruar, nuk kam autorizimin zyrtar, nuk punoj në organizata shtetërore, nuk punoj në asnjë organizatë biznesi dhe nuk jam i licencuar si ekzaminier për testimin e kandidatëve në teori dhe praktikë”*.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

17. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
18. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.*

*[...]*

*(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

19. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] dhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik”.*  
(...).

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

20. Gjykata merr parasysh edhe rregullin 39 (1) (a) [Kriteret e pranueshmërisë], të Rregullores së punës, që specifikon:

Rregulli 39  
[Kriteret e pranueshmërisë]

*“1. Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

*(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar;  
[...]*”

21. Në vlerësimin nëse parashtruesi i kërkesës i plotëson kriteret kushtetuese dhe ligjore për vlerësimin e kushtetutshmërisë së kërkesës së tij, Gjykata rikujton se në bazë të nenit 113 të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë në Gjykatë shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë nga *“autoritetet publike”*, pasi të kenë shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj. I njëjti kriter është po ashtu i përcaktuar në nenin 47 të Ligjit.
22. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren që parashtruesi i kërkesës nuk konteston asnjë akt të një autoriteti publik që mund të ketë rezultuar në shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të tij. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon t'i jenë cenuar nga ndonjë akt i autoritetit publik, ashtu si kërkohet me nenin 48 të Ligjit.

23. Në fakt, parashtruesi kërkon interpretim *in abstrakto* të legjislacionit në lidhje me “*pozitës zyrtare*” dhe nëse ai ka statusin e “*personit zyrtar*”, në cilësinë e instruktorit të praktikës në autoshkollën “Geni”, që do të mund t’i shërbente për të zgjidhur një konflikt të mundshëm në lidhje me pozitën e tij të punës. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk sqaron nëse kjo kërkesë ndërlidhet me rastin e tij KI76/18, ku ai ishte parashtrues dhe për të cilin Gjykata kishte nxjerrë Aktvendim për Papranueshmëri.
24. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese, sipas nenit 113, paragrafi 1 të Kushtetutës ka juridiksion të vendosë vetëm për rastet e ngritura para saj në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
25. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se “individët” (personat fizikë dhe juridikë), sipas kuptimit të nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nuk kanë të drejtë t’i drejtohen drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese dhe të kërkojnë nga ajo të vlerësojë *in abstrakto* kushtetutshmërinë e një norme ligjore, apo të ngritin para saj çështje hipotetike të interpretimit të ligjeve për të cilat nuk janë të autorizuar, sipas nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI60/17, parashtrues: *KRU “Radoniqi” Gjakovë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 tetorit 2017, paragrafi 30).
26. Andaj, Gjykata rithekson se kërkesat të cilat në thelb ngrenë çështje të ligjshmërisë, siç është rasti konkret, si rregull, bien nën juridiksionin e gjykatave të rregullta. Në të vërtetë, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me pretendimin dhe interpretimin e legjislacionit relevant për të përcaktuar nëse parashtruesi i kërkesës, si instruktor i praktikës në autoshkollën “Geni”, ka statusin e “*personit zyrtar*” (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI27/17, parashtrues: *Maliq Zeqiri*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 nëntorit 2017, paragrafi 24).
27. Gjykata mund të ndërhyj vetëm atëherë kur pretendimet për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë argumentohen në baza kushtetuese dhe bien brenda juridiksionit të saj të përcaktuar me Kushtetutë, pasi që të jenë përmbushur të gjitha kriteret formale dhe procedurale të kërkuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të elaboruara më lart (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI27/17, parashtrues: *Maliq Zeqiri*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 nëntorit 2017, paragrafi 25).
28. Rrjedhimisht, nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata konstaton se parashtruesi nuk është palë e autorizuar siç përcaktohet me nenin 113, paragrafi 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës, dhe si e tillë kërkesa është e papranueshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafi 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe në pajtim me Rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës, më 27 maj 2019, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 te Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatën Kushtetuese

Radomir Laban

Arta Rama-Hajrizi

